



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT BESNIK DOKUSHI

URDHËR

“për vënien e sekuestros konservative”

Drejtuar: QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT, TIRANË  
Për dijeni: Shoqeria “Agro Food Company” shpk me NIPT L81716017B  
Për dijeni: Autoriteti Kombetar i Ushqimit

Pranë Zyrës së Përmbarduesit Gjyqësor Privat Besnik DOKUSHI me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbardimore me palë:

Debitori: Shoqeria “Agro Food Company” shpk me NIPT L81716017B  
Kreditore: Autoriteti Kombetar i Ushqimit  
Objekti: Pagim Gjore

Unë Përmbarduesi Gjyqësor privat Besnik DOKUSHI pasi shqyrtova materialin e dosjes përmbardimore:

KONSTATOVA:

Për titullin ekzekutiv “Vendim Përfundimtar i Inspektimit” nr. AKU-TR-2019-003312-5 datë 06.06.2019 i Deges Rajonale te Qarkut Tirane, me palë kreditore Autoriteti Kombetar i Ushqimit dhe me palë debitorë Shoqeria “Agro Food Company” shpk me NIPT L81716017B, me objekt:

“ekzekutimin e titullit ekzekutiv “Vendim Përfundimtar i Inspektimit”. nr. AKU-TR-2019-003312-5 datë 06.06.2019 i Deges Rajonale te Qarkut Tirane”

Në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile nga ana e jonë është marrë vendimi i kalimit në ekzekutim të detyrueshëm duke vendosur masën e sekuestros në aksionet/kuotat e palës debitore.

**Për këtë arsye:**

Në bazë të nenit 527 e në vijim të K.Pr.Civile

URDHËROJMË:

1. Qendrën Kombëtare të Biznesit, të bëjë verifikimin dhe bllokimin e aksioneve /kuotave të debitorit **Shoqeria “Agro Food Company” shpk me NIPT L81716017B**, si dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave/aksioneve duke ndaluar tjetërsimin dhe ose disponimin e tyre dhe moskryerjen e asnjë lloj veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrimit tregtar .
2. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga ana jonë.
3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
4. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
5. Ky urdhër mbahet dhe ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga masa dijeni.

PËRMBARUESI GJYQËSOR  
BESNIK DOKUSHI

